

VENDIM
Nr. 159, datë 25.2.2015

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 944, DATË 9.10.2013, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË
SHTETËRORE TË MINISTRISË SË ZHVILLIMIT URBAN DHE TURIZMIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 944, datë 9.10.2013, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Në titull dhe kudo në vendim, emërtimi “Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit” zëvendësohet me “Ministria e Zhvillimit Urban”.

2. Në fund të kreut II, fjalët “... dhe turizmit.” hiqen.

3. Kreu III ndryshohet, si më poshtë vijon:

“III. Ministria e Zhvillimit Urban ushtron, në përputhje me legjislacionin përkatës, veprimtarinë e saj në këto fusha përgjegjësie shtetërore:

1. Fushën e planifikimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm urban, administrimit të tokës dhe kontrollit të zhvillimit të territorit;

2. Fushën e legalizimit, urbanizimit dhe integritit të zonave e ndërtimeve informale;

3. Fushën e standardeve urbane në ndërtim;

4. Fushën e strehimit;

5. Fushën e mbetjeve urbane në lidhje me planifikimin territorial;

6. Fushën e menaxhimit të projekteve të zhvillimit urban.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama